



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 27 shtator 2021
Nr. ref.:1849/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI36/21

Parashtrues

Sylë Osmani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
PML. nr. 352/2020, të 20 janarit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Gresa Caka-Nimani, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Sylë Osmani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) me vendbanim në Gjakovë. Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga Korab Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 335/2020, të 23 dhjetorit 2020, në ndërlidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 305/2020, të 15 tetorit 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, DKR. PKR. nr. 42/2020, të 26 qershorit 2020.
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës, më 29 janar 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 33 (3) [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 18 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 26 shkurt 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 4 mars 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe nga i njëjti kërkoi plotësimin e formularit të kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës në pajtim me Ligjin iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

10. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
11. Më 8 shtator 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që ta deklarojë kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 4 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës, gjatë kohës sa ishte duke e drejtuar automjetin e tij, ishte ndaluar nga policia e Republikës së Kosovës. Pas një kontrole të zakonshme zyrtarët policorë në automjetin e tij gjetën një armë zjarri pa leje përkatëse dhe një sasi municioni.
13. Më 13 shtator 2020, Prokuroria Themelore në Gjakovë, kundër parashtruesit të kërkesës ngriti aktakuzë PP. nr. 1054/2019 për shkak të kryerjes së veprës penale "*mbajtjeje në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve*" nga neni 366, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK).
14. Më 26 qershor 2020, Gjykata Themelore në Gjakovë, me Aktgjykimin PKR. nr. 42/2020, e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak të kryerjes së veprës penale nga neni 366, paragrafi 1 i KPRK-së, duke e dënuar atë me burgim efektiv, në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, pasi kishte vlerësuar specifikat e rastit në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së.
15. Në afat ligjor, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, të 26 qershorit 2020, për shkak të vendimit në lidhje me sanksionin penal (dënimin), duke kërkuar shqiptimin e një dënimi më të butë ndaj tij.
16. Më 15 tetor 2020, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin PAKR. nr. 305/2020, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe konfirmoi Aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit, duke iu referuar pretendimeve të mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës në lidhje me lartësinë e dënimit, konstatoi se ankesa në këtë çështje nuk qëndron dhe është e pabazuar.
17. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke propozuar që aktgjykimet e kontestuara të ndryshohen sa i përket vendimit për dënimin dhe të dënuarit t'i shqiptohet dënim me kusht ose me gjobë.
18. Më 22 dhjetor 2020, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me parashtresën KMLP. II. nr. 195/2020, propozoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e parashtruesit të kërkesës të refuzohet, si e pabazuar.

19. Më 20 janar 2021, Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktgjykimit PML. nr. 352/2020, refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të cilën e kishte ushtruar kundër Aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, të 15 tetorit 2020 dhe Aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, të 26 qershorit 2020, duke arsyetuar se *“në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, përmes individualizimit të dënimit parashtruesit të kërkesës i ka shqiptuar dënimin brenda kufijve të paraparë për këtë veprë penale”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet e kontestuar të gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 33 (3) [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNj).

Pretendimet për shkelje të nenit 3 dhe 24 të Kushtetutës

21. Përkitazi me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson se dënimi i shqiptuar ndaj tij, me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve për veprën penale të ngarkuar, nuk është praktikë juridike e gjyqësorit të Kosovës, përkundër faktit që praktika juridike nuk e obligon gjykatën, ajo duhet të shërbejë si indikator, me qëllim të trajtimit të barabartë para ligjit të qytetarëve, përkatësisht mosdiskriminimin e tyre, vlera këto të garantuara me nenin 3 dhe 24 të Kushtetutës.

Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës

22. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës Supreme nuk përmbajnë arsye bindëse se përse pretendimet e tij, të ngritura në ankesë dhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk qëndronin dhe ishin të pabazuara sa i përket vendimit për dënimin. Në këtë kuptim parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat respektive thjeshtë kanë pranuar gjetjet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me shqiptimin e sanksionit penal. Mbi këtë bazë parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të Gjykatës Kushtetuese KI97/19, e cila kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së, për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar.

Pretendimet për shkelje të nenit 33 (3) të Kushtetutës

23. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson se gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit kanë bërë vlerësim të gabuar të rrethanave të rastit në dëm të tij, sepse si rrethanë rënduese është marrë fakti se ai ishte dënuar më parë për vepra të tjera penale. Në këtë kontekst parashtruesi i kërkesës argumenton se neni 100 i Kodit penal nr. 04/L-082, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-129 dhe Ligjin nr. 04/L-273, po ashtu edhe neni 93 i Kodit të ri penal nr. 06/L-074, përcaktojnë se pasojat juridike nuk krijohen nëse kryesi i veprës penale më parë është dënuar me kusht, vërejtje gjyqësore ose me gjobë. Andaj duke qenë kështu parashtruesi i kërkesës

pretendon se aktgjykimet e kontestuarra bien ndesh me nenin 33, paragrafin 3 të Kushtetutës, sepse ashpërsia e dënimit, sipas tij, është në disproporcion me veprën penale të kryer.

Pasqyra e zgjidhjes së kërkuar me kërkesë

24. Në fund, parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës që kërkesa e tij të deklarohet e pranueshme, të konstatohet shkelje e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, si dhe shkelje të nenit 33 të Kushtetutës; dhe t' i shpallë aktgjykimet e kontestuarra të gjykatave të rregullta të pavlefshme.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

27. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”

28. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: 1) legjitimohet si palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; 2) i njëjti e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin PML. nr. 352/2020 të Gjykatës Supreme, të 20 janarit 2020; 3) i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të fjalisë së dytë të nenit 113. 7 të Kushtetutës dhe paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit; 4) i ka specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, të cilat pretendohet se i janë shkelur, si dhe e ka specifikuar aktin e autoritetit publik kushtetutshmërinë e të cilit e konteston, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe 5) e ka parashtruar kërkesën brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh të paraparë në nenin 49 të Ligjit.
29. Megjithatë, Gjykata gjithashtu merr parasysh kërkesat e rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënregullin (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

30. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GjEDNj-së, *Kemmachev kundër Francës*, Aplikimi nr.17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, Aplikimi nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).
31. Gjykata, rikujton se parashtruesi i kërkesës ngrenë pretendimet përkitazi me: i. shkeljen e të drejtës për barazi para ligjit, e garantuar me nenin 3 dhe 24 të

Kushtetutës; ii. shkeljen e të drejtës për vendim të arsyetuar, e cila garantohet me nenin 31 të Kushtetutës; dhe iii. shkeljen e të drejtave të garantuara me paragrafin 3 të nenit 33 të Kushtetutës.

32. Gjykata, në vlerësimin e pretendimeve të mësipërme, do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

i. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 3 dhe 24 të Kushtetutës

33. Përkitazi me këtë pretendim, Gjykata rikujton përmbajtjen e nenit 24 të Kushtetutës, dhe të nenit 14 të KEDNJ-së:

Neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”
[...]

Neni 14 [Ndalimi i Diskriminimit] i KEDNJ-së

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

34. Gjykata, bazuar në praktikën e GjEDNJ-së dhe praktikën e vetë rikujton se në mënyrë që një çështje të ngritet në kuadër të nenit 24 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të KEDNJ-së, duhet të ekzistojë dallimi në trajtim ndërmjet personave në situata të ngjashme ose të krahasueshme (shih rastin e GjEDNJ-së, *X dhe të tjerët kundër Austrisë*, Aktgjykim i 19 shkurtit 2013, paragrafi 98). Për më tepër, Gjykata rikujton se jo çdo dallim në trajtim përbën shkelje të neneve të lartcekura. Në parim, dallimi në trajtim do të jetë diskriminues nëse i mungon justifikimi objektiv apo i arsyeshëm; thënë ndryshe, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim apo nëse mungon marrëdhënia e arsyeshme ndërmjet mjeteve që përdoren dhe synimit që synohet të arrihet (shih rastin e GjEDNJ-së, *Guberina kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 22 marsit 2016, paragrafi 69 dhe referencat e tjera të përmendura aty).
35. Në rrethanat e rastit konkret, parashtuesi i kërkesës, pretendimin për shkelje të barazisë para ligjit e mbështet në faktin se dënimi i shqiptuar ndaj tij, në kohëzgjatje prej 10 muajve, për veprën penale e cila është objekt i kësaj çështjeje

penale, nuk është praktikë juridike e gjyqësorit të rregullt edhe përkundër faktit se praktika juridike nuk është obligative për gjykatën, ajo duhet të shërbejë si indikator, me qëllim të trajtimit të barabartë para ligjit të qytetarëve, përkatësisht mosdiskriminimin e tyre.

36. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se përveç faktit që parashtruesi i kërkesës i referohet standardeve kushtetuese të “barazisë së qytetarëve para ligjit” ai tutje nuk argumenton se ku qëndron dallimi në trajtim dhe në bazë të cilit element ose status personal të paraprë me nenin 24 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të KEDNj-së ai është diskriminuar.
37. Thënë këtë, Gjykata konsideron se aktgjykimet e kontestuarra të gjykatave të rregullta nuk përmbajnë elemente të shkeljes së parimit të barazisë para ligjit, siç pretendon parashtruesi i kërkesës. Për më tepër, asnjë nga bazat e kërkuara me nenin 24 të Kushtetutës, kur këto interpretohen në dritën e nenit 14 të KEDNj-së nuk e mbështesin pretendimin e tij për shkeljen e kësaj të drejte themelore (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI173/18, parashtrues *Nijazi Pasoma*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 32).
38. Për më tepër, pretendimi për shkelje të së drejtës për barazi para ligjit me tepër elaborohet në drejtim të moskonsistencës së praktikës gjyqësore, e cila ngrenë çështje kushtetuese nga e drejta për gjykim të drejtë. Megjithatë, edhe në këtë aspekt parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë prove materiale, me të cilën do të dëshmonte se gjykatat e rregullta në rrethana tërësisht të ngjashme “faktike” dhe “juridike” sikurse të tij kanë vendosur ndryshe ose në favor të qytetarëve të tjerë.
39. Nga sa me lartë, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për “barazi para ligjit” të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 14 të KEDNj-së, i takojnë kategorisë së tretë (iii) *pretendime të pambështetura apo të paarsyetuara*, dhe si të tilla Gjykata në baza kushtetuese i deklaron qartazi të pabazuara.

ii. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së

40. Përkitazi me këtë pretendim konkret, Gjykata rikujton përmbajtjen e paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

[...]

41. Përveç kësaj, Gjykata rikujton gjithashtu përmbajtjen e nenit 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së, i cili përcakton:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë ... edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”
[...]

Parimet e përgjithshme për të drejtën për vendim të arsyetuar

42. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.) Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019, KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).
43. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNj-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih rastin e GJEDNj-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin KI87/18, parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
44. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNj-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani*

kundër Spanjës, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Morerira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

45. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI96/16 *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017 shih rastet e Gjykatës KI87/18 parashtrues *"IF Skadeforsikring"*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44; KI138/19 parashtrues *Ibish Raci*, cituar më lart, paragrafi 45; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 138).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme për të drejtën për vendim të arsyetuar në rrethanat e rastit konkret

46. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës përkitazi me këtë pretendim thekson se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës Supreme nuk përmbajnë arsye bindëse se përse pretendimet e tij, të ngritura në ankesë dhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ishin të paqëndrueshme dhe të pabazuara në lidhje me vendimin për dënimin. Në këtë kuptim parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat respektive thjeshtë kanë pranuar gjetjet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me shqiptimin e sanksionit penal (dënimin).
47. Në vazhdim, Gjykata i referohet pjesëve relevante të aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, që adresojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me vendimin për dënimin, gjegjësisht shqiptimin e sanksionit penal ndaj tij.
48. Fillimisht, Gjykata i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, e cila me rastin e marrjes së vendimit përkitazi me dënimin, ndaj parashtruesit të kërkesës, ka arsyetuar se në rastin e tij janë vlerësuar të gjitha rrethanat e çështjes në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat kanë ndikuar në zgjedhjen e llojit dhe të lartësisë së dënimit. Në këtë rast, gjykata respektive ka arsyetuar se si rrethanë lehtësuese për parashtruesin e kërkesës është marrë gjendja e dobët ekonomike, si i papunë, se gjatë gjykimit ai ka pasur sjellje dhe qëndrim korrekt dhe se është penduar për kryerjen e veprës penale, duke premtuar mospërsëritjen e veprimeve të tilla në të ardhmen. Ndërsa përkitazi

me rrethanat renduese gjykata respektive, arsyetoi se parashtruesi i kërkesës është person recidivist, që ka kryer disa veprave penale, dhe se i njëjti ka qenë i dënuar me 6 (gjashtë) aktgjykime të plotfuqishme nga kjo gjykatë. Prandaj, duke marrë për bazë që i njëjti ka qenë i gjykuar me dënim me gjobë për vepra të llojit të njëjtë dhe për veprat e tjera penale, këtë fakt gjykata respektive e ka marrë si rrethanë renduese për parashtruesin e kërkesës, ngase ka ardhur në përfundim se *“me dënimin e shqiptuar...do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim, si i tillë, i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit”*.

49. Gjukata tutje i referohet Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, e cila arsyetoi se: *“...dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të saj dhe është në funksion të preventives së përgjithshme, posaçërisht asaj të posaçme dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 38 të KPRK-së. Për shqiptim të një dënimi me të butë siç; propozon mbrojtja, nuk janë plotësuar kushtet ligjore, e aq më parë kur nuk theksohen rrethana të reja apo të atilla vendimtare të cilat do të arsyetonin dënim me të butë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi i mbrojtjes se gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të dënimeve të mëparshme të akuzuarit si rrethana renduese ka vepruar në kundërshtim me nenin 93 të KPRK-së, sepse ato dënime konform dispozitave në fjalë nuk prodhojnë pasoja juridike pasi që dënimet janë me gjobë ose me kusht, sepse gjykata e shkallës së parë në rastin konkret ka vepruar në pajtim me rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit, parashikuar me nenin 70 të KPRK-së dhe të akuzuarit konform dispozitës në fjalë ia ka vlerësuar si rrethanë renduese (neni 70, par. 2 nënpar. 2.13 të KPRK-së) dhe dënimin e ka shqiptuar në kufirin e dënimit të paraparë për atë vepër penale”*.
50. Për më tepër, Gjukata vëren se të njëjtin pretendim parashtruesi i kërkesës e kishte ngritur në Gjykatën Supreme, e cila arsyetoi: *“Gjukata Supreme e Kosovës, konstaton se konform dispozitës së nenit 385, par. 5 të KPPK-së, kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënimin, dënimin alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm, për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar rrethanat lidhur me dënimin, përmes individualizimit të dënimit, të dënuarit i ka shqiptuar dënimin brenda kufijve të paraparë për këtë vepër penale. Në rast se nuk është fjala për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimit është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e cila do të mund të ndërlidhej me mungesën ose paqartësitë e arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur”*.

51. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta në mënyrë specifike i janë përgjigjur pretendimit të parashtruesit të kërkesës dhe mbrojtësit të tij, në lidhje me vendimin për dënim, përkatësisht lartësinë e dënimit, duke vlerësuar se në rastin e tij u morën parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese të rasti dhe mbi bazën e individualizimit të dënimit parashtruesit të kërkesës i është shqiptuar dënimi brenda kufijve të paparaparë me veprën penale.
52. Gjykata, dëshiron të rikujtojë gjithashtu, se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato të kërkohej përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GjEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1994; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, [DHM], paragrafi 81.).
53. Për sa më sipër, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në rrafshin praktik, koncepti i “drejtësisë procedurale” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI128/19, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI22/19, parashtrues i kërkesës *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
54. Gjykata, konsideron se në rastin e parashtruesit të kërkesës janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura nga ana e gjykatave të rregullta, vendimtarja e të cilave është në pajtueshmëri të plotë me standardet e kërkuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës edhe me tej mund të mos jetë i kënaqur me rezultatin e gjykimit të çështjes së tij, megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GjEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
55. Andaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, si të tilla, i takojnë kategorisë së tretë (iii) “pretendime të pambështetura apo të paarsyetuara” prandaj edhe në këtë pjesë kërkesa është qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 33 (3) të Kushtetutës

56. Gjykata në fillimisht rikujton përmbajtjen e paragrafit 3, të nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Raste Penale] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 33

[Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Raste Penale] i Kushtetutës

[...]

3. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.

[...]

57. Në vazhdim, Gjykata ve në pah se pretendimin për shkeljen të nenit 33.3 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës e bazon në faktin se gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese përkitazi me matjen e dënimit ndaj tij kanë bërë vlerësim të gabuar të rrethanave të rastit në dëm të tij, sepse si rrethanë rënduese është marrë fakti se ai ishte dënuar më parë për vepra të tjera penale. Në këtë kontekst parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 100 të KPRK-së nr. 04/L-082, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-129 dhe Ligjin nr. 04/L-273, si dhe nenit 93 të Kodit të ri penal nr. 06/L-074, nene të cilat sipas parashtruesit të kërkesës përcaktojnë se pasojat juridike nuk krijohen nëse kryesi i veprës penale më parë është dënuar me kusht, vërejtje gjyqësore ose me gjobë.
58. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës, se në rastin e tij gjykatat e rregullta duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese përkitazi me matjen e dënimit, kanë bërë vlerësim të gabuar të rrethanave në dëm të tij, Gjykata verën se ky pretendim tashme është adresuar si më sipër nga Gjykata në kuadër të së drejtës për vendim të arsyetuar, dhe nuk e konsideron të nevojshme ta përsërisë (shih paragrafët 47, 48 dhe 49 të këtij dokumenti).
59. Ndërsa sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se “ashpërsia e dënimit të shqiptuar është në disproporcion me veprën penale” për të cilën ai është shpallur fajtor dhe dënuar, Gjykata vlerëson se ky pretendim në të vërtetë ngrenë çështje kushtetuese nga paragrafi 3 i nenit 33 të Kushtetutës. Për të arritur në një vlerësim objektiv, Gjykata thekson se dispozita kushtetuese në fjalë, kërkon referim në dispozitën përkatëse të KPRK-së, me të cilën përcaktohen kufijtë minimal dhe maksimal të sanksionit penal për veprën penale përkatëse.
60. Në lidhje me këtë, Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor dhe është dënuar nga gjykata e shkallës së parë për kryerjen e veprës penale nga neni 366, paragrafit 1, i KPRK-së, i cili përcakton:
- “1. Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.”*
61. Nga sa më lartë, Gjykata, vlerëson se përmbajtja e dispozitës së mësipërme parasheh dy forma të sanksionimit, në kufijtë maksimal: 1) aplikimin e gjobës

deri në 7.500 euro; ose 2) dënimin me burgimi efektiv deri në 5 (pesë) vjet. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se lartësia e dënimit me burgim efektiv, në kohëzgjatje prej 10 muajve, e shqiptuar ndaj parashtruesit të kërkesës është brenda kufijve të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 366 të KPRK-së. Thënë këtë, Gjykata vlerëson se ashpërsia e dënimit në rastin e parashtruesit të kërkesës nuk duket të jetë në disproporcion me veprën penale të ngarkuar nga neni 366 (1) i KPRK-së.

62. Andaj, nga shtjellimet e mësipërme, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës se *ashpërsia e dënimit është në disproporcion me veprën penale*, i takojnë kategorisë së dytë (ii) që karakterizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”* dhe si të tilla, të njëjtat në baza kushtetuese Gjykata i deklaron qartazi të pabazuara, dhe rrjedhimisht të papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Përfundim

63. Si përmbledhje, Gjykata lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, për të drejtën për vendim të arsyetuar, i kualifikon si pretendime të kategorisë së tretë (iii) *pretendime të pambështetura dhe të paarsyetuara*; ndërsa pretendimet për shkelje të nenit 33.3 të Kushtetutës, Gjykata i kualifikon si pretendime të kategorisë së dytë (ii) që karakterizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”* dhe si të tilla, të njëjtat në baza kushtetuese janë qartazi të pabazuara.
64. Andaj, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në tërësinë e saj, duhet të deklarohet qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht e papranueshme, siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit, me rregullat 39 (2) dhe 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 8 shtator 2021, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani